



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2409 Prot

Gramsh më 08.07.2022

VENDIM

Nr. 55 dt. 30 /06/2022

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga forca madhore (tërmeti) i datës 21.09.2019 dhe 26.11.2019, të konstatuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në banesën e shtetasit Agim Peci, banor në fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblimin financiar të kësaj familje”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2022, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti i rënë në Shtator – Nëntor 2019, në banesën e shtetasit **Agim Peci**, banor në Fshatin Kabash, Njësia Administrative Poroçan, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlogaritur bazuar në dëmet në banesë të shkaktuara si pasojë e lekundjeve të tërmeteve Shtator – Nëntor 2019, për shtetasin **Agim Peci, fshati Kabash, Njësia Administrative Poroçan**, në vlerën **600 000** (gjashtëqind mijë) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Agim Peci, ndihmën emergjente në vlerën prej **600 000 (gjashtëqind mijë)** lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2022.

4. Ndhurma financiare për familjen e shtetasin Agim Peci, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndhurma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Agim Peci, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e lekundjeve të tërmeteve Shtator – Nëntor 2019.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

